



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:291853
Datë: 11.11.2024
Numri i dokumentit: 06432374

C.nr.4519/23

GJYKATA THEMELORE NË P...–Departamenti Përgjithshëm, me gjyqtarin Vegim Maloku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit G.... (G.)..... Ç....., nga P..., të cilin e përfaqëson M.I , avokat në P..., kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme -Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Prishtinë, të cilën e përfaqëson Ministria e Drejtësisë, Avokatura Shtetërore, Prishtinë, baza juridike: pagesa e pagave shpërblyese (13- ta), vlera e kontestit: 2,500 €, në shqyrtim kryesor të mbajtur, me datë 24.10.2024, në prezencën e të autorizuarit të paditësit, e në mungesë të autorizuarit të paditurës, me datë 11.11.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT kërkesëpadia e paditësit G.... (G.)..... Ç....., nga P..., SI E BAZUAR ashtu që: DETYROHET e paditura Ministrisë së Punëve të Brendshme-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë që paditësit në emër të pagës shpërblyese për fund vit (pagës së 13-të) për vitet 2020, vitin 2021 dhe 2022, t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,875.06€, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë datë 21.12.2023, e deri në pagesën definitive dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 260 euro, e të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënim përmbarimi.
- II. REFUZHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit G.... (G.)..... Ç....., nga P..., përtej shumës së gjykuar, me të cilën ka kërkuar që të: DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme–Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, që në emër të pagës shpërblyese për fund vit (pagës së 13-të) për vitin 2019 në

shumën prej 625.02€, e me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë 21.12.2023 e gjerë në pagesën definitive e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënimin e përmbarimit.”, SI E PA BAZUAR.

A r s y e t i m

Historiku i procedurës:

Paditësi G.... (G.)..... Ç....., nga P..., të cilin e përfaqëson M.I, avokat në P..., me datë 21.12.2023 ka paraqitur padi në Gjykatën Themelore në P... – Departamenti i përgjithshëm civil, kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme-Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Prishtinë, të cilën e përfaqëson Ministria e Drejtësisë, Avokatura Shtetërore, Prishtinë, me bazë juridike: pagesa e pagave shpërblyese, vlera e kontestit: 2,500 €.

Pretendimet e ndergjyqësve:

Paditësi G.... (G.)..... Ç.... në padi ka theksuar se është i punësuar me orar të plotë, në vazhdimësi pa ndërprerë, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, respektivisht në Policinë e Kosovës që nga data 17.01.2005 e deri në momentin e paraqitjes së padisë (datë 21.12.2023) dhe për punën e tij merr pagë mujore prej 652.02€. Policia e Kosovës me datë 14.11.2018 ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018, me anën e të cilit Policëve që kanë performancë të mirë, obligohet të u paguaj pagën e trembëdhjetë, pagë ekuivalente me pagën mujore prej 652€. Pasi e paditura nuk ka paguar këto mjete, paditësi i drejtohet Gjykatës dhe kërkon aprovimin e padisë si tërësisht të bazuar dhe të detyrohet e paditura Ministria e Punëve të Brendshme–Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, që të paguajë në emër të pagës së fund vitit shumën nga 625.02€ për vitet 2019, 2020,2021 dhe 2022 në shumën prej 2,500€, e me kamatë ligjore prej 8% në vite, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë e gjerë në pagesën definitive nën kërcënimin e përmbarimit.

Në fjalë përfundimtare i autorizuari i palës paditëse ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësorë dhe pas administrimit të provave u vërtetua qartë baza e kërkesëpadisë, e cila gjenë mbështetje në nenin 29 (e drejta në pagë dhe shpërblime) të udhëzimit administrativ Nr. 02/2018 mbi marrëdhënien e punë në Policinë e Kosovës, ku parashihet se zyrtarët policorë të cilët nuk kanë

qenë objekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore, si shpërblim përfitojnë një pagë mujorë ekuivalente me pagën e rregullt të fund vitit – pagën e 130-të. Një gjë e tillë është paraparë edhe me nenin 30 të udhëzimit administrativ Nr. 01/202., i cili parasheh të njëjtat të drejta në punë, si dhe me mendimin juridik të Gjykatës Supreme, sipas të cilit paditësit i takon paga e 13-të.

I autorizuari i të paditurit në fjalën përfundimtare në emër të shpenzimeve të procedurës ka kërkuar 104€, për një seancë ka kërkuar 135€ dhe për taksë gjyqësore 21€, në një shumë totale prej 260€.

E paditura me përgjigje në padi, e ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se pagesa e deklaruar nga ana e paditësit është me nivelizimin e pagave, respektivisht sipas Ligjit NR.08/L-196 për pagat në sektorin publik. Po ashtu ka shtuar se paditësi kërkesëpadinë e ka në kundërshtim me nenin 87 të Ligjit Ligjit Nr.03/L-212 të Punës si dhe në kundërshtim me nenin 341 dhe 342 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), e si të tillë e ka kërkesëpadinë të parashkruar. Thekson se kërkesëpadia e paditësit është po ashtu në kundërshtim me mendimin e Gjykatës Supreme, me numër reference 213/23 të datës 09.10.2023, si dhe me nenin 46 të Ligjit NR.08/L-196 për pagat në sektorin publik. Tutje thekson se paditësi nuk i ka shterur mjetet e rregullta të ankimit, bazuar në dispozitat e nenit 78 dhe 79 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës.

E paditura gjegjësisht i autorizuari i saj, nuk ka prezantuar në seancat e shqyrtimit gjyqësor të datës 23.10.2024, edhe përkundër faktit se i njëjti ka qenë i ftuar nga ana e gjykatës në mënyrë të rregullt, me çka gjykata konform nenit 423 par.4 të LPK-së, seancën e ka mbajtur në mungesë të tij, por me datë 16.10.2024 gjykatës i kanë paraqitur një parashtrësë – deklaram për seancë, me të cilën kanë deklaruar se nuk mund të marrin pjesë në seancë dhe se mbeten në tërësi pranë kundërshtimeve të dhëna në përgjigjen në padi, si dhe kundërshtojnë edhe më tutje kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar në ligj.

Provat e administruara nga gjykata:

Gjykata për vërtetimin e plotë dhe të saktë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike kontestimore ka administruar provat si në vijim: Vërtetim punësimi i datës 04.12.2023 me numër 0./1-01/.../2., i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës- Drejtoria e

Përgjithshme e Policisë për paditësin G.... (G.)..... Ç.... dhe 9 (nëntë) formularët e performancës për periudhën kohore nga viti 2019 deri në vitin 2023, të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për paditësin G.... (G.)..... Ç.....

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku në lidhshmëri me njëra-tjetrën, çmuarjes me kujdes e ndërgjegje të secilës provë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që me provat e administruara gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Kontestuese në mes palëve ndërgjyqësve ishte sa a i takon apo jo paditësit paga shpërblyese për çdo vit kalendarik, respektivisht për vitet 2019, 2020,2021 dhe 2022 – pagat e 13-ta, dhe nëse kërkesa e paditësit është e parashkruar.

Nga vërtetimi punësim për paditësin i datës 04.12.2023 me numër 0./1-01/.../2., i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka themeluar marrëdhënie punë me të paditurën Policinë e Kosovës me orar të plotë që nga data 17.01.2005 dhe atë në pozitën me gradë: Polic i lartë. Paga momentale e paditësit është 652.02€.

Nga nëntë (9) formulatët e performancës të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për paditësin G.... (G.)..... Ç....., gjykata ka vërtetuar faktet si në vijim:

-Nga formulari i parë (1) i performancës - për periudhën kohore 14.11.2018 deri me 01.01.2019, se paditësi është i punësuar tek e paditura që nga data 17.01.2005 dhe mban gradën Polic i lartë - pozita zyrtar në ekipin reagues dhe është vlerësuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me nivel të vlerësimit me notën katër(4), që nënkupton plotësisht i kënaqshëm, fakte të cilat ishin të pa kontestuar edhe nga pala e paditura;

-Nga formulari i dytë (2) i performancës - për periudhën kohore 01.09.2020-20.09.2020, se paditësi është i punësuar tek e paditura që nga data 17.01.2005 dhe mban gradën Polic i lartë - pozita zyrtar patrollues, dhe është vlerësuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me nivel të vlerësimit me notën katër(4), që nënkupton plotësisht i kënaqshëm, fakte të cilat ishin të pa kontestuar edhe nga pala e paditura;

-Nga formulari i tretë (3) i përfomancës - për periudhën kohore 21.09.2020-31.12.2020, se paditësi është i punësuar tek e paditura që nga data 17.01.2005 dhe mban gradën Polic i lartë - pozita zyrtar patrollues, dhe është vlerësuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me nivel të vlerësimit me notën katër(4), që nënkupton plotësisht i kënaqshëm, fakte të cilat ishin të pa kontestuara edhe nga pala e paditura;

-Nga formulari i katërt(4) i përfomancës - për periudhën kohore 05.03.2020-31.05.2020, se paditësi është i punësuar tek e paditura që nga data 17.01.2005 dhe mban gradën Polic i lartë - pozita zyrtar në ekipin reagues, dhe është vlerësuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me nivel të vlerësimit me notën katër(4), që nënkupton plotësisht i kënaqshëm, fakte të cilat ishin të pa kontestuara edhe nga pala e paditura;

-Nga formulari i pestë (5) i përfomancës - për periudhën kohore 01.06.2020-31.08.2020, se paditësi është i punësuar tek e paditura që nga data 17.01.2005 dhe mban gradën Polic i lartë - pozita zyrtar patrollues, dhe është vlerësuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me nivel të vlerësimit me notën katër(4), që nënkupton plotësisht i kënaqshëm, fakte të cilat ishin të pa kontestuara edhe nga pala e paditura;

-Nga formulari i gjashtë (6) i përfomancës - për periudhën kohore 01.01.2020-04.03.2020, se paditësi është i punësuar tek e paditura që nga data 17.01.2005 dhe mban gradën Polic i lartë - pozita mbikëqyrës në ekipin reagues, dhe është vlerësuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me nivel të vlerësimit me notën katër(4), që nënkupton plotësisht i kënaqshëm, fakte të cilat ishin të pa kontestuara edhe nga pala e paditura;

-Nga formulari i shtatë (7) i përfomancës - për periudhën kohore 01.01.2021-25.04.2021, se paditësi është i punësuar tek e paditura që nga data 17.01.2005 dhe mban gradën Polic i lartë - pozita zyrtar patrollues, dhe është vlerësuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me nivel të vlerësimit me notën pesë (5), që nënkupton se i tejkalon kërkesat, fakte të cilat ishin të pa kontestuara edhe nga pala e paditura;

-Nga formulari i tetë(8) i përfomancës - për periudhën kohore 26.04.2021-31.12.2021, se paditësi është i punësuar tek e paditura që nga data 17.01.2005 dhe mban gradën Polic i lartë - pozita zyrtar patrollues, dhe është vlerësuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë me nivel të vlerësimit me notën pesë (5), që nënkupton se i tejkalon kërkesat, fakte të cilat ishin të pa kontestuara edhe nga pala e paditura; dhe

-Nga formulari i nëntë (9) i përfomancës - për periudhën kohore 24.09.2022-31.12.2022, se paditësi është i punësuar tek e paditura që nga data 17.01.2005 dhe mban gradën Polic i lartë - pozita zyrtar i kontrollit në pikë kalim kufitar, dhe është vlerësuar nga mbikëqyrësi i

drejtpërdrejtë me nivel të vlerësimit me notën katër (4), që nënkupton plotësisht i kënaqshëm, fakte të cilat ishin të pa kontestuar edhe nga pala e paditura.

Bazuar në nenin 329, paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), që përcakton se *„Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, andaj gjykata i mori të besueshme provat e bashkëngjitura nga paditësi, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuara nga organi shtetëror dhe nga vetë e paditura, kurse kjo e fundit nuk ka dorëzuar ndonjë prooë me të cilën vërtetohet e kundërta.

Nga provat e administruar si më lartë, gjykata ka ardhë në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, ashtu që ka vërtetuar gjendjen faktike se i njëjti është i punësuar tek e paditura, kurse përgjatë vitit 2020, 2021 dhe 2022, ka marrë vlerësime të kënaqshme dhe që i tejkalojnë kërkesat, andaj i takon e drejta për kompensim për një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit. Kjo gjenë mbështetje në nenin 44, paragrafi 2 të Ligjit për Policinë që përcakton se *„Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”*; nenin 55, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 se *„Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji”*, e lidhur me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, që në nenin 5.par.2 përcakton se *„Në polici janë të punësuar tri kategori të personelit policor”*; pika 2 e këtij se *“Stafi civil, i cili punësohet në Polici për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative”*; si dhe nenin 29, paragrafi 2 ku përcaktohet se *„Personelit të policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”*, një të drejtë e parasheh edhe neni 30 par.2 i Udhëzimit Administrativ me nr.01/2021, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, me një shtesë se *“nëse ka mjete buxhetore”*.

Në interpretim të këtyre dispozitave ligjore dhe mënyrës së aplikimit të tyre, Gjykata Supreme e Kosovës, me Mendimin juridik nr.213-2023 të datës 09.10.2023, për shpërblimin e shujtës ditore, pagës së 13-të, shtesat në pagë për kualifikim shkollor dhe pagën jubilarë në Policinë e Kosovës, ka sqaruar se nga përmbajtja e dispozitave të nenin 29.2 të UA 02-18, personeli i

policisë kanë të drejtë për shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018,2019,2020 dhe 2021 nëse plotësohen kushtet dhe atë: që personelit të policisë që kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës. Në këtë rast, edhe pse UA 01-21 që ka hyrë në fuqi me datë 29.09.2021 është shfuqizuar UA nr.02-18, por personeli i policisë kanë të drejtë që edhe për vitin 2021 të përfitojnë shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse plotësohen kushtet e dhëna më lartë, për arsye se nenin 29 par.2 i UA nr.02-18, ka qenë në fuqi deri me datën 29.09.2021 dhe ka qenë i karakterit detyrues, sipas të cilit punëdhënësi ka qenë i obliguar që edhe për vitin 2021 të planifikojë mjetet buxhetore, ndërsa është i papranueshëm çdo arsyetim eventual për mungesë të mjeteve buxhetore. UA nr. 01-21, konkretisht neni 30 par. 2, në mënyrën se si është formuluar kjo dispozitë, personelit të policisë i njihet e drejta në pagën e sipër theksuar, nëse plotësohen kushtet e theksuara, mirëpo realizimi i shpërblimit është i kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, përkatësisht nëse ka mjete buxhetore. Sipas, Gjykatës Supreme të Kosovës, kjo dispozitë duhet interpretuar në atë mënyrë që e drejta për realizim të pagës së 13- të, nuk lind me plotësimin e kushteve si vlerësim i kënaqshëm dhe mos të qenët subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore, brenda vitit përkatës, por që e drejta në shpërblimin e tillë lind kur punëdhënësi nuk e përmbush atë, ndërsa në asnjë mënyrë nuk arrin të provojë se nuk ka pasë mundësi buxhetore. Sipas kësaj gjykate, nëse punëtori paraqet kërkesë për kompensimin e shpërblimit të pagës së 13 –të, duke pretenduar se ka plotësuar kushtet e përcaktuara me UA të sipër theksuar, mbetet në barrën e punëdhënësit që në secilën fazë të procedurë, kur gjykata i jep mundësi për tu deklaruar me prova konkrete, të provojë çështjen e mundësisë buxhetore për një shpërblim të tillë.

Gjykata vendosi si në piken I të dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e aprovuar pjesërisht kërkesën e paditësit për vitet 2020,2021 dhe 2022, sepse për dy vitet e para paditësi ka sjellë prova që kërkohen sipas UA në fuqi, kurse nuk ka qenë subjekt i ndonjë procedure disiplinore, ndërsa sa i përket pagës për vitin 2022, ka qenë obligim i të paditurës që të dëshmoje pamundësinë buxhetore, kurse një gjë të tillë nuk e ka provuar me asnjë provë, edhe pse e ka pasë këtë mundësi me përgjigje në padi dhe në shqyrtim kryesor.

Gjykata sa i përket pagës bazë të paditësit, në këtë rast edhe pse nga vërtetimi i dorëzuar si provë, vërtetohet se i njëjti ka pagë bazë prej 652.02 euro, gjykata ka vendosur sa i përket pagës bazë në lartësi prej 625.02 euro, sepse nuk ka mundur që ta tejkalojë kërkesën e palës paditëse. Bazuar

në nenin 2.1 të LPK-së “Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse.”

Gjykata i ka vlerësuar edhe prapësimet e tjera të palës së paditur, e posaçërisht pretendimin se dispozita e nenit 29, të Udhëzimit Administrativ, nr.02/2018 për marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës dhe UA nr.01/2021 nuk është i obligueshëm përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore–financiare nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së 13-të, mirëpo një pretendim i tillë për gjykatën është i pathemeltë sepse Udhëzimi Administrativ i lartcekur është akt juridik i veçantë që zyrtarëve të Policisë së Kosovës ua njeh këtë të drejtë, pra ai është (*lex specialis*) me të cilin rregullohet çështja e pagave dhe shpërblimeve në marrëdhënie të punës dhe si i tillë duhet zbatuar, çka do të thotë se nuk ka vend për interpretim ndryshe, kurse nuk ka sjellë prova për të vërtetuar pamundësinë buxhetore, e të cilën e ka pasë si obligim bazuar në nenin 7 e lidhur me nenin 319 të LPK-së, e as nuk e ka provuar të kundërtën se paditësi ka qenë subjekt i ndonjë procedure disiplinore.

Pjesa Refuzuese e kërkesëpadisë

Gjykata sa i përket pjesës refuzuese të kërkesëpadisë, i ka marrë si të bazuara pretendimet e palës së paditur të dhëna në përgjigje në padi, vetëm sa i përket pagës së 13-të për performancë në shumën prej 625 euro për vitin 2019, se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës, parashkruhen brenda afatit prej tri(3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës, andaj në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesë të parashkruar, sepse padia është paraqitë në gjykatë në vitin 21.12.2023, ashtu paga për vitin 2019 është e parashkruar, sepse bazuar në neni 87 të Ligjit të Punës “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë kuptim, kërkesat në para, në këtë rast në paga janë kërkesa periodike, ku secilës pagë mujore, veç e veç i rrjedhë afati i parashkrimit. UA i viti 2018, ka hyrë në fuqi me datë 14.11.2018, ashtu që paditësit e drejta në kompensim të pagës së 13-të për vitin 2019, i ka lindë në fund të vitit 2019, përkatësisht në ditën e fundit të vitit kur merret paga, kurse afati i parashkrimit ka filluar që të rrjedhë nga data 01.01.2020 e jashtë afatit kërkesa ka qenë që nga data 01.01.2023, kurse padia është paraqitë me datë 21.12.2023. Pra kjo kërkesë është parashkruar në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës.

Gjykata, për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr.04/L-077 të datës 19.06.2012, ku shprehimisht është përcaktuar se „*Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë*”.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore bazuar nenit 449, 452 dhe 463 të LPK-së, dhe lartësia e këtyre shpenzimeve është llogaritur duke u bazuar në Tarifën e OAK për kontestet deri në 10,000 euro, ashtu që në këtë rast padia është në shumë prej 104 euro, për një seancë në shumë prej 135 euro dhe taksë për padi në shumë prej 21 euro, e që në total bëjnë shumën prej 260 euro.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE P...
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:291853, C.nr.4519/23, Dt.11.11.2024

Gj y q t a r i
Vegim Maloku

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes të kësaj gjykate.